



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2026 – Numri: 21

Tiranë – E martë, 27 janar 2026

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 1/2026, datë 22.1.2026	Për ratifikimin e marrëveshjes së pranimi të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Kryeministri Edi Rama, në Kartën e Bordit të Pagues..... 1935
Dekret i Presidentit nr. 39, datë 27.1.2026	Për shpallje ligji..... 1947



LIGJ
Nr. 1/2026

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES
SË PRANIMIT TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA
KRYEMINISTRI EDI RAMA,
NË KARTËN E BORDIT TË PAQES

Në mbështetje të neneve 78, 81, pika 1, 83, pikat 1 dhe 2, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja e pranimi të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Kryeministri Edi Rama, në Kartën e Bordit të Paqes sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 22.1.2026

Shpallur me dekretin nr. 39, datë 27.1.2026
të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bajram Begaj

KARTA E BORDIT TË PAQES

PARATHËNIE

Duke deklaruar se paqja e qëndrueshme kërkon gjykim pragmatik, zgjidhje të arsyeshme dhe kurajon për të dalë nga qasjet dhe institucionet që shpeshherë kanë dështuar;

Duke njohur se paqja e qëndrueshme rrënjësohet kur njerëzit fuqizohen për të marrë pronësinë dhe përgjegjësinë mbi të ardhmen e tyre;

Duke pohuar se vetëm partneriteti i qëndrueshëm, i orientuar nga rezultatet, i bazuar në ndarjen e barrëve dhe angazhimeve të përbashkëta,

mund të sigurojë paqen në vende ku ajo ka qenë kaq gjatë e paarrtshme;

Duke shprehur ankimin që shumë qasje për ndërtimin e paqes nxisin varësi të përhershme dhe institucionalizojnë krizën, në vend që të drejtojnë njerëzit përtej saj;

Duke theksuar nevojën për një organ ndërkombëtar më të shpejtë dhe më efektiv për ndërtimin e paqes; dhe

Duke vendosur të bashkojë një koalicion shtetesh të gatshme, të përkushtuara ndaj bashkëpunimit praktik dhe veprimit efektiv,

Me gjykim të udhëhequr dhe drejtësi të nderuar, me këtë akt Palët miratojnë Kartën për Bordin e Paqes.

KAPITULLI I - QËLLIMET DHE
FUNKSIONET

Neni 1: Misioni

Bordi i Paqes është një organizatë ndërkombëtare që synon të nxisë stabilitetin, të rivendosë qeverisje të besueshme dhe të ligjshme, dhe të garantojë paqe të qëndrueshme në zonat e prekura ose të kërcënuara nga konflikti. Bordi i Paqes do të ndërmarrë funksione të tilla për ndërtimin e paqes në përputhje me të drejtën ndërkombëtare dhe sipas asaj që mund të miratohet në përputhje me këtë Kartë, përfshirë zhvillimin dhe përhapjen e praktikave më të mira të zbatueshme nga të gjitha kombet dhe komunitetet që kërkojnë paqe.

KAPITULLI II - ANËTARËSIA

Neni 2.1: Shtetet anëtare

Anëtarësia në Bordin e Paqes është i kufizuar vetëm për shtetet e ftuara nga Kryetari për të marrë pjesë, dhe fillon me njoftimin se shteti ka pranuar të jetë i lidhur ligjërisht nga kjo Kartë, në përputhje me kapitullin XI.

Neni 2.2: Përgjegjësitë e shteteve anëtare

a) Secili shtet anëtar do të përfaqësohet në Bordin e Paqes nga kryetari i shtetit ose qeveria.

b) Secili shtet anëtar do të mbështesë dhe ndihmojë në operacionet e Bordit të Paqes në



përputhje me kompetencat e tij të brendshme ligjore. Asgjë në këtë Kartë nuk duhet interpretuar si dhënie e juridiksionit Bordin të Paqes brenda territorit të shteteve anëtare, ose si detyrim që shtetet anëtare të marrin pjesë në një mision të caktuar për ndërtimin e paqes pa pëlqimin e tyre.

c) Secili shtet anëtar do të shërbejë një mandat jo më shumë se tre vjet nga hyrja në fuqi e kësaj Karte, në bazë të rinovimit nga Kryetari. Mandati tre-vjeçar i anëtarësisë nuk do të aplikohet për shtetet anëtare që kontribuojnë më shumë se 1,000,000,000 USD në fonde me para të gatshme për Bordin e Paqes brenda vitit të parë të hyrjes në fuqi të Kartës.

Neni 2.3: Përfundimi i anëtarësisë

Anëtarësia do të përfundojë me ndodhjen e së parës nga këto situata:

i) skadimi i mandatit tre-vjeçar, në bazë të nenit 2.2(c) dhe rinovimit nga Kryetari;

ii) tërheqja, në përputhje me nenin 2.4;

iii) një vendim për largim nga Kryetari, në bazë të vetos nga një shumicë prej dy të tretave të shteteve anëtare; ose

iv) shpërbërja e Bordin të Paqes në përputhje me kapitullin X.

Një shtet anëtar, anëtarësia e të cilit përfundon, gjithashtu ndalon së qenuri Palë në Kartë, por ky shtet mund të ftohet përsëri që të bëhet shtet anëtar, në përputhje me nenin 2.1.

Neni 2.4: Tërheqja

Çdo shtet anëtar mund të tërhiqet nga Bordi i Paqes me efekt të menjëhershëm, duke i dhënë njoftim me shkrim Kryetarit.

KAPITULLI III - QEVERISJA

Neni 3.1: Bordi i Paqes

a) Bordi i Paqes përbëhet nga shtetet e tij anëtare.

b) Bordi i Paqes do të votojë për të gjitha propozimet në rendin e tij të ditës, përfshirë në lidhje me buxhetet vjetore, krijimin e njësive vartëse, emërimin e drejtuesve të lartë ekzekutivë dhe përcaktimet kryesore të politikave, të tilla si miratimi i marrëveshjeve ndërkombëtare dhe ndjekja e nismave të reja për ndërtimin e paqes.

c) Bordi i Paqes do të mbledhet në mbledhje votimi të paktën një herë në vit dhe në kohë dhe vende të tjera shtesë që Kryetari i çmon të përshtatshme. Rendi i ditës në këto mbledhje do të përcaktohet nga Bordi Ekzekutiv, në bazë të njoftimit dhe dhënies së komenteve nga shtetet anëtare dhe miratimit nga Kryetari.

d) Secili shtet anëtar do të ketë një votë për Bordin e Paqes.

e) Vendimet do të merren me shumicën e shteteve anëtare të pranishme dhe që votojnë, në bazë të miratimit nga Kryetari, i cili mund të hedhë gjithashtu votën e tij në cilësinë e Kryetarit në rast barazimi votash.

f) Bordi i Paqes do të zhvillojë gjithashtu mbledhje të rregullta jo-votuese me Bordin e tij Ekzekutiv, gjatë të cilave shtetet anëtare mund të paraqesin rekomandime dhe udhëzime në lidhje me veprimtarinë e Bordin Ekzekutiv, si dhe gjatë të cilave Bordi Ekzekutiv do t'i raportojë Bordin të Paqes mbi veprimtarinë dhe vendimet e Bordin Ekzekutiv. Këto mbledhje do të thirren të paktën çdo tre muaj, ndërsa koha dhe vendi i këtyre mbledhjeve do të përcaktohen nga Drejtori Ekzekutiv i Bordin Ekzekutiv.

g) Shtetet anëtare mund të zgjedhin të përfaqësohen nga një zyrtar i lartë zëvendësues në të gjitha mbledhjet, me miratimin e Kryetarit.

(h) Kryetari mund t'u dërgojë ftesa organizatave përkatëse rajonale të integritetit ekonomik për të marrë pjesë në procedurat e Bordin të Paqes, sipas termave dhe kushteve që ai i çmon të përshtatshme.

Neni 3.2: Kryetari

a) Donald J. Trump do të shërbejë si Kryetari inaugurues i Bordin të Paqes dhe, veçmas, do të shërbejë si përfaqësuesi inaugurues i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, duke iu nënshtruar vetëm dispozitave të kapitullit III.

b) Kryetari do të ketë autoritet ekskluziv për të krijuar, ndryshuar ose shpërbërë njësi vartëse, sipas nevojës ose sipas vlerësimit të përshtatshëm, për përmbushjen e misionit të Bordin të Paqes.

Neni 3.3: Pasardhësia/suksedimi dhe zëvendësimi

Kryetari do të caktojë në çdo kohë një pasardhës për rolin e Kryetarit. Zëvendësimi i Kryetarit mund



të ndodhë vetëm pas dorëheqjes vullnetare ose si pasojë e paaftësisë, siç përcaktohet me një votë unanime të Bordit Ekzekutiv, moment në të cilin pasardhësi i caktuar nga Kryetari do të marrë menjëherë detyrën e Kryetarit dhe të gjitha detyrat dhe kompetencat përkatëse të Kryetarit.

Neni 3.4: Nënkomitetet

Kryetari mund të krijojë nënkomitete sipas nevojës ose sipas vlerësimit të përshtatshëm dhe do të përcaktojë mandatin, strukturën dhe rregullat e qeverisjes për secilin nënkomitet të tillë.

KAPITULLI IV - BORDI EKZEKUTIV

Neni 4.1: Përbërja dhe përfaqësimi i Bordit Ekzekutiv

a) Bordi Ekzekutiv përzgjidhet nga Kryetari dhe përbëhet nga liderë me autoritet dhe reputacion ndërkombëtar.

b) Anëtarët e Bordit Ekzekutiv ushtrojnë mandatin për një periudhë dyvjeçare, me të drejtë shkarkimi nga Kryetari dhe me mundësi rinovimi sipas diskrecionit të tij.

c) Bordi Ekzekutiv drejtohet nga një Drejtor Ekzekutiv i emëruar nga Kryetari dhe i konfirmuar me shumicën e votave të Bordit Ekzekutiv.

d) Drejtori Ekzekutiv thërret mbledhjet e Bordit Ekzekutiv çdo dy javë gjatë tre muajve të parë pas krijimit të tij dhe më pas mbi bazë mujore, si dhe mbledhje shtesë sipas vlerësimit të Drejtorit Ekzekutiv.

e) Vendimet e Bordit Ekzekutiv merren me shumicën e anëtarëve të pranishëm dhe që votojnë, përfshirë Drejtorin Ekzekutiv. Këto vendime hyjnë në fuqi menjëherë, në bazë të vetos nga Kryetari në çdo kohë më pas.

f) Bordi Ekzekutiv përcakton rregulloren e vet të brendshme të procedurës.

Neni 4.2: Mandati i Bordit Ekzekutiv

Bordi Ekzekutiv:

a) Ushtron kompetencat e nevojshme dhe të përshtatshme për zbatimin e misionit të Bordit të Paqes, në përputhje me këtë Kartë;

b) I raporton Bordit të Paqes mbi veprimtarinë dhe vendimet e tij mbi baza tremujore, në përputhje

me nenin 3.1(f), si dhe në momente të tjera sipas përcaktimit të Kryetarit.

KAPITULLI V - DISPOZITAT FINANCIARE

Neni 5.1: Shpenzimet

Financimi i shpenzimeve të Bordit të Paqes do të sigurohet përmes fondeve vullnetare nga shtetet anëtare, shtete të tjera, organizata ose burime të tjera.

Neni 5.2: Llogaritë

Bordi i Paqes mund të autorizojë krijimin e llogarive, sipas nevojës, për të përmbushur misionin e tij. Bordi Ekzekutiv do të autorizojë vendosjen e mekanizmave të kontrollit dhe mbikëqyrjes në lidhje me buxhetet, llogaritë financiare dhe disbursimet, sipas nevojës ose sipas vlerësimit të përshtatshëm, për të garantuar integritetin e tyre.

KAPITULLI VI - STATUSI JURIDIK

Neni 6

a) Bordi i Paqes dhe njësitë e tij vartëse zotërojnë personalitet juridik ndërkombëtar. Ata do të kenë zotësi juridike të nevojshëm për përmbushjen e misionit të tyre (përfshirë, por pa u kufizuar tek zotësia për të lidhur kontrata, për të blerë dhe shitur pronë të paluajtshme dhe të luajtshme, për të filluar procedime ligjore, për të hapur llogari bankare, për të marrë dhe disbursuar fonde private dhe publike, dhe për të punësuar staf).

b) Bordi i Paqes do të sigurojë dhënien e privilegjeve dhe imuniteteve të nevojshme për ushtrimin e funksioneve të Bordit të Paqes, njësi të tij vartëse dhe personelit të tyre, të cilat do të vendosen në marrëveshje me shtetet ku Bordi i Paqes dhe njësitë vartëse operojnë ose përmes masave të tjera që mund të merren nga ato shtete në përputhje me kërkesat e tyre të brendshme ligjore. Bordi mund t'i delegojë autoritetin për të negociuar dhe për të lidhur këto marrëveshje ose rregullime tek zyrtarë të caktuar brenda Bordit të Paqes dhe/ose njësiteve të tij vartëse.

**KAPITULLI VII - INTERPRETIMI DHE ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE****Neni 7**

Mosmarrëveshjet e brendshme midis dhe ndërmjet shteteve anëtare të Bordit të Paqes, njërive dhe personelit, për çështjet që lidhen me Bordin e Paqes, duhet të zgjidhen përmes bashkëpunimit miqësor, në përputhje me autoritetet organizative të vendosura nga kjo Kartë, dhe për këto qëllime, Kryetari është autoriteti përfundimtar në lidhje me kuptimin, interpretimin dhe zbatimin e kësaj Karte.

KAPITULLI VIII - NDRYSHIMET E KARTËS**Neni 8**

Ndryshimet në Kartë mund të propozohen nga Bordi Ekzekutiv ose nga të paktën një e treta e shteteve anëtare të Bordit të Paqes që veprojnë së bashku. Ndryshimet e propozuara do të shpërndahen tek të gjitha shtetet anëtare të paktën tridhjetë (30) ditë përpara se të hidhen në votim. Ndryshime të tilla do të miratohen me miratimin e shumicës prej dy të tretave të Bordit të Paqes dhe konfirmimin nga Kryetari. Ndryshimet në kapitujt II, III, IV, V, VIII dhe X kërkojnë miratim unanim të Bordit të Paqes dhe konfirmim nga Kryetari. Pasi të përmbushen kërkesat përkatëse, ndryshimet do të hyjnë në fuqi në datën e specifikuar në rezolutën e ndryshimit ose menjëherë nëse nuk specifikohet asnjë datë.

KAPITULLI IX - REZOLUTA OSE DIREKTIVA TË TJERA**Neni 9**

Kryetari, duke vepruar në emër të Bordit të Paqes, autorizohet që të miratojë rezoluta ose direktiva të tjera, në përputhje me këtë Kartë, për të zbatuar misionin e Bordit të Paqes.

KAPITULLI X - KOHËZGJATJA, SHPËRBËRJA DHE TRANZICIONI**Neni 10.1: Kohëzgjatja**

Bordi i Paqes vazhdon të funksionojë deri në shpërbërjen e tij në përputhje me këtë kapitull, kohë në të cilën kjo Kartë gjithashtu do të përfundojë.

Neni 10.2: Kushtet për shpërbërjen

Bordi i Paqes do të shpërbëhet në kohën që Kryetari e çmon të nevojshme ose të përshtatshme, ose në fund të çdo viti kalendarik me numër tek, përveç nëse rinovohet nga Kryetari jo më vonë se më 21 nëntor të këtij viti kalendarik me numër tek. Bordi Ekzekutiv do të përcaktojë rregullat dhe procedurat në lidhje me shlyerjen e të gjithë aktivëve, pasivëve dhe detyrimeve në rast shpërbërjeje.

KAPITULLI XI - HYRJA NË FUQI**Neni 11.1: Hyrja në fuqi dhe zbatimi i përkohshëm**

a) Kjo Kartë hyn në fuqi pas shprehjes së pëlqimit për t'u lidhur ligjërisht nga tre shtete.

b) Shtetet të cilat kërkohet të ratifikojnë, pranojnë ose miratojnë këtë Kartë përmes procedurave të brendshme, bien dakord të zbatojnë përkohësisht kushtet e kësaj Karte, përveç nëse këto shtete kanë njoftuar Kryetarin në kohën e nënshkrimit se nuk janë në gjendje ta bëjnë këtë. Të tilla shtete që nuk e zbatojnë përkohësisht këtë Kartë, mund të marrin pjesë si anëtarë pa të drejtë vote në procedurat e Bordit të Paqes deri në ratifikimin, pranimin ose miratimin e Kartës, në përputhje me kërkesat e tyre ligjore të brendshme, në bazë të miratimit nga Kryetari.

Neni 11.2: Depozitari

Teksti origjinal i kësaj Karte, si dhe çdo ndryshim i saj, do të depozitohet tek Shtetet e Bashkuara të Amerikës, të cilat me këtë akt caktohen si Depozitari i kësaj Karte. Depozitari do t'u sigurojë menjëherë të gjithë nënshkruesve të kësaj Karte një kopje të certifikuar të tekstit origjinal të kësaj Karte, si dhe të çdo ndryshimi ose protokollit shtesë të saj.

**KAPITULLI XII - REZERVAT****Neni 12**

Nuk mund të bëhen rezerva ndaj kësaj Karte.

**KAPITULLI XIII - DISPOZITA TË
PËRGJITHSHME****Neni 13.1: Gjuha zyrtare**

Gjuha zyrtare e Bordit të Paqes do të jetë gjuha angleze.

Neni 13.2: Selia qendrore

Bordi i Paqes dhe njësitë e tij vartëse mund të krijojnë, në përputhje me Kartën, një seli qendrore dhe zyra në terren. Bordi i Paqes do të negociojë një marrëveshje për selinë qendrore dhe marrëveshje që rregullojnë zyrat në terren me shtetin ose shtetet pritëse, sipas nevojës.

Neni 13.3: Vula

Bordi i Paqes do të ketë një vulë zyrtare, e cila do të miratohet nga Kryetari.

NË DËSHMI TË KËSAJ, të nënshkruarit, të autorizuar sipas rregullave, kanë nënshkruar këtë Kartë.



CHARTER OF THE BOARD OF PEACE

PREAMBLE

Declaring that durable peace requires pragmatic judgment, common-sense solutions, and the courage to depart from approaches and institutions that have too often failed;

Recognizing that lasting peace takes root when people are empowered to take ownership and responsibility over their future;

Affirming that only sustained, results-oriented partnership, grounded in shared burdens and commitments, can secure peace in places where it has for too long proven elusive;

Lamenting that too many approaches to peace-building foster perpetual dependency, and institutionalize crisis rather than leading people beyond it;

Emphasizing the need for a more nimble and effective international peace-building body; and

Resolving to assemble a coalition of willing States committed to practical cooperation and effective action,

Judgment guided and justice honored, the Parties hereby adopt the Charter for the Board of Peace.

CHAPTER I — PURPOSES AND FUNCTIONS

Article 1: Mission

The Board of Peace is an international organization that seeks to promote stability, restore dependable and lawful governance, and secure enduring peace in areas affected or threatened by conflict. The Board of Peace shall undertake such peace-building functions in accordance with international law and as may be approved in accordance with this Charter, including the development and dissemination of best practices capable of being applied by all nations and communities seeking peace.

CHAPTER II — MEMBERSHIP

Article 2.1: Member States

Membership in the Board of Peace is limited to States invited to participate by the Chairman, and commences upon notification that the State has consented to be bound by this Charter, in accordance with Chapter XI.

**Article 2.2: Member State Responsibilities**

- (a) Each Member State shall be represented on the Board of Peace by its Head of State or Government.
- (b) Each Member State shall support and assist with Board of Peace operations consistent with their respective domestic legal authorities. Nothing in this Charter shall be construed to give the Board of Peace jurisdiction within the territory of Member States, or require Member States to participate in a particular peace-building mission, without their consent.
- (c) Each Member State shall serve a term of no more than three years from this Charter's entry into force, subject to renewal by the Chairman. The three-year membership term shall not apply to Member States that contribute more than USD \$1,000,000,000 in cash funds to the Board of Peace within the first year of the Charter's entry into force.

Article 2.3: Termination of Membership

Membership shall terminate upon the earlier of: (i) expiration of a three-year term, subject to Article 2.2(c) and renewal by the Chairman; (ii) withdrawal, consistent with Article 2.4; (iii) a removal decision by the Chairman, subject to a veto by a two-thirds majority of Member States; or (iv) dissolution of the Board of Peace pursuant to Chapter X. A Member State whose membership terminates shall also cease to be a Party to the Charter, but such State may be invited again to become a Member State, in accordance with Article 2.1.

Article 2.4: Withdrawal

Any Member State may withdraw from the Board of Peace with immediate effect by providing written notice to the Chairman.

CHAPTER III — GOVERNANCE**Article 3.1: The Board of Peace**

- (a) The Board of Peace consists of its Member States.
- (b) The Board of Peace shall vote on all proposals on its agenda, including with respect to the annual budgets, the establishment of subsidiary entities, the appointment of senior executive officers, and major policy determinations, such as the approval of international agreements and the pursuit of new peace-building initiatives.
- (c) The Board of Peace shall convene voting meetings at least annually and at such additional times and locations as the Chairman deems appropriate. The agenda at such meetings shall be



set by the Executive Board, subject to notice and comment by Member States and approval by the Chairman.

(d) Each Member State shall have one vote on the Board of Peace.

(e) Decisions shall be made by a majority of the Member States present and voting, subject to the approval of the Chairman, who may also cast a vote in his capacity as Chairman in the event of a tie.

(f) The Board of Peace shall also hold regular non-voting meetings with its Executive Board at which Member States may submit recommendations and guidance with respect to the Executive Board's activities, and at which the Executive Board shall report to the Board of Peace on the Executive Board's operations and decisions. Such meetings shall be convened on at least a quarterly basis, with the time and place of said meetings determined by the Chief Executive of the Executive Board.

(g) Member States may elect to be represented by an alternate high-ranking official at all meetings, subject to approval by the Chairman.

(h) The Chairman may issue invitations to relevant regional economic integration organizations to participate in the proceedings of the Board of Peace under such terms and conditions as he deems appropriate.

Article 3.2: Chairman

(a) Donald J. Trump shall serve as inaugural Chairman of the Board of Peace, and he shall separately serve as inaugural representative of the United States of America, subject only to the provisions of Chapter III.

(b) The Chairman shall have exclusive authority to create, modify, or dissolve subsidiary entities as necessary or appropriate to fulfill the Board of Peace's mission.

Article 3.3: Succession and Replacement

The Chairman shall at all times designate a successor for the role of Chairman. Replacement of the Chairman may occur only following voluntary resignation or as a result of incapacity, as determined by a unanimous vote of the Executive Board, at which time the Chairman's designated successor shall immediately assume the position of the Chairman and all associated duties and authorities of the Chairman.

Article 3.4: Subcommittees

The Chairman may establish subcommittees as necessary or appropriate and shall set the mandate, structure, and governance rules for each such subcommittee.



CHAPTER IV — EXECUTIVE BOARD

Article 4.1: Executive Board Composition and Representation

- (a) The Executive Board shall be selected by the Chairman and consist of leaders of global stature.
- (b) Members of the Executive Board shall serve two-year terms, subject to removal by the Chairman and renewable at his discretion.
- (c) The Executive Board shall be led by a Chief Executive nominated by the Chairman and confirmed by a majority vote of the Executive Board.
- (d) The Chief Executive shall convene the Executive Board every two weeks for the first three months following its establishment and on a monthly basis thereafter, with additional meetings convened as the Chief Executive deems appropriate.
- (e) Decisions of the Executive Board shall be made by a majority of its members present and voting, including the Chief Executive. Such decisions shall go into effect immediately, subject to veto by the Chairman at any time thereafter.
- (f) The Executive Board shall determine its own rules of procedure.

Article 4.2: Executive Board Mandate

The Executive Board shall:

- (a) Exercise powers necessary and appropriate to implement the Board of Peace's mission, consistent with this Charter;
- (b) Report to the Board of Peace on its activities and decisions on a quarterly basis, consistent with Article 3.1(f), and at additional times as the Chairman may determine.

CHAPTER V — FINANCIAL PROVISIONS

Article 5.1: Expenses

Funding for the expenses of the Board of Peace shall be through voluntary funding from Member States, other States, organizations, or other sources.

Article 5.2: Accounts

The Board of Peace may authorize the establishment of accounts as necessary to carry out its mission. The Executive Board shall authorize the institution of controls and oversight



mechanisms with respect to budgets, financial accounts, and disbursements, as necessary or appropriate to ensure their integrity.

CHAPTER VI — LEGAL STATUS

Article 6

(a) The Board of Peace and its subsidiary entities possess international legal personality. They shall have such legal capacity as may be necessary to the pursuit of their mission (including, but not limited to, the capacity to enter into contracts, acquire and dispose of immovable and movable property, institute legal proceedings, open bank accounts, receive and disburse private and public funds, and employ staff).

(b) The Board of Peace shall ensure the provision of such privileges and immunities as are necessary for the exercise of the functions of the Board of Peace and its subsidiary entities and personnel, to be established in agreements with the States in which the Board of Peace and its subsidiary entities operate or through such other measures as may be taken by those States consistent with their domestic legal requirements. The Board may delegate authority to negotiate and conclude such agreements or arrangements to designated officials within the Board of Peace and/or its subsidiary entities.

CHAPTER VII — INTERPRETATION AND DISPUTE RESOLUTION

Article 7

Internal disputes between and among Board of Peace Members, entities, and personnel with respect to matters related to the Board of Peace should be resolved through amicable collaboration, consistent with the organizational authorities established by the Charter, and for such purposes, the Chairman is the final authority regarding the meaning, interpretation, and application of this Charter.

CHAPTER VIII — CHARTER AMENDMENTS

Article 8

Amendments to the Charter may be proposed by the Executive Board or at least one-third of the Member States of the Board of Peace acting together. Proposed amendments shall be circulated to all Member States at least thirty (30) days before being voted on. Such amendments shall be adopted upon approval by a two-thirds majority of the Board of Peace and confirmation by the



Chairman. Amendments to Chapters II, III, IV, V, VIII, and X require unanimous approval of the Board of Peace and confirmation by the Chairman. Upon satisfaction of the relevant requirements, amendments shall enter into force on such date as specified in the amendment resolution or immediately if no date is specified.

CHAPTER IX — RESOLUTIONS OR OTHER DIRECTIVES

Article 9

The Chairman, acting on behalf of the Board of Peace, is authorized to adopt resolutions or other directives, consistent with this Charter, to implement the Board of Peace's mission.

CHAPTER X — DURATION, DISSOLUTION AND TRANSITION

Article 10.1: Duration

The Board of Peace continues until dissolved in accordance with this Chapter, at which time this Charter will also terminate.

Article 10.2: Conditions for Dissolution

The Board of Peace shall dissolve at such time as the Chairman considers necessary or appropriate, or at the end of every odd-numbered calendar year unless renewed by the Chairman no later than November 21 of such odd-numbered calendar year. The Executive Board shall provide for the rules and procedures with respect to the settling of all assets, liabilities, and obligations upon dissolution.

CHAPTER XI — ENTRY INTO FORCE

Article 11.1: Entry into Force and Provisional Application

- (a) This Charter shall enter into force upon expression of consent to be bound by three States.
- (b) States required to ratify, accept, or approve this Charter through domestic procedures agree to provisionally apply the terms of this Charter, unless such States have informed the Chairman at the time of their signature that they are unable to do so. Such States that do not provisionally apply this Charter may participate as Non-Voting Members in Board of Peace proceedings pending ratification, acceptance, or approval of the Charter consistent with their domestic legal requirements, subject to approval by the Chairman.

**Article 11.2: Depositary**

The original text of this Charter, and any amendment thereto, shall be deposited with the United States of America, which is hereby designated as the Depositary of this Charter. The Depositary shall promptly provide a certified copy of the original text of this Charter, and any amendment or additional protocols thereto, to all signatories to this Charter.

CHAPTER XII — RESERVATIONS**Article 12**

No reservations may be made to this Charter.

CHAPTER XIII — GENERAL PROVISIONS**Article 13.1: Official Language**

The official language of the Board of Peace shall be English.

Article 13.2: Headquarters

The Board of Peace and its subsidiary entities may, in accordance with the Charter, establish a headquarters and field offices. The Board of Peace will negotiate a headquarters agreement and agreements governing field offices with the host State or States, as necessary.

Article 13.3: Seal

The Board of Peace will have an official seal, which shall be approved by the Chairman.

IN WITNESS WHEREOF, the undersigned, being duly authorized, have signed this Charter.

FOR THE REPUBLIC OF ALBANIA:

PRIME MINISTER

EDI RAMA

Date:



DEKRET
Nr. 39, datë 27.1.2026

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 1/2026, “Për ratifikimin e marrëveshjes së pranimi të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Kryeministri Edi Rama, në Kartën e Bordit të Pages”.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**



	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2026

Adresa: Rr. “Nikolla Jorga”, Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 64 lekë

